



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J62005002O

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë , më \_\_\_/\_\_\_/ 2016

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Për:** Operatorin ekonomik “**INSTITUTI DEKLIADA-ALB**”sh.p.k me nr. NIPT-i K71606006A, me administrator Z.Devis Hasalami me adresë: Rruga “Dora Distra“, Tiranë.

**Procedura e prokurimit:** “Kërkesë për Propozim”

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e një hidrocentrali të ri në Lanabregas”.

**Fondi Limit:** 7,900,000 (shtatë milion e nëntëqind mijë) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** Të ardhurat e SH.A Ujësjetllës-Kanalizime, Tiranë.

**Kohëzgjatja e kontratës ose afati për ekzekutim:** 60 ditë kalendarike duke nisur nga data e nënshkrimit të kontratës.

**Data e zhvillimit të tenderit është:** 11/11/2016

**Buletini i Njoftimeve Publike:** Nr.44 datë 07/11/2016

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik ”**E.B.S.**” sh.p.k NIPT-i K72014002P  
Vlerë: **4,800,000** (katër milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “**INSTITUTI DEKLIADA-ALB**”sh.p.k NIPT-i K71606006A  
Vlerë: **5,400,000** (pesë milion katërqind mijë) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik JV “**INVIKTUS**” NIPT-i L12213005M  
& “ **C.E.C. GROUP**” sh.p.k  
Vlerë: **5,925,000** (pesë milion e nëntëqind e njëzet e pesë mijë) lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik “**GR ALBANIA**” sh.p.k NIPT-i L01509004N  
Vlerë: **6,750,000** (gjashtë milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00 355 42240978  
[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)  
NIPT J62005002O

5. Operatori ekonomik **“MEI Business Consultancy” sh.p.k.**, NIPT-i L01628003L  
Vlera: **6,800,000** (gjashtë milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH.
6. Operatori ekonomik **“Loreco & CO” sh.p.k** NIPT-i J61903071B  
Vlerë prej **7,500,000** (shtatë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH

#### **Janë skualifikuar për arsyet si më poshtë:**

1. Operatori ekonomik **“E.B.S.” sh.p.k** me nr. NIPT-i K72014002P me administrator Z.Fahri Maho me ofertë ekonomike me vlerë prej 4,800,000 (katër milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH, **ka** mangësi në dokumentacionin e kërkuar në Dokumentat e Tenderit në përputhje me Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Pranimi/Kualifikimit, si më poshtë vijon:
  - Nuk ka plotësuar kriterin e percaktuar në shtojcën 6 pika 2.1.2 ku përcaktohet se: *Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: “Vërtetim lëshuar nga Komuna ose Bashkia për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2015 dhe 2016.*  
Operatori ekonomik “E.B.S” shpk, nuk ka paraqitur vërtetim lëshuar nga Bashkia Tiranë lidhur me pagesën e taksave vendore për vitin 2015 dhe 2016; por për vitin 2016 ka paraqitur “Njoftim detyrimi” i cili nuk është i njëvlefshëm me vërtimin që duhet të ishte lëshuar nga strukturat vendore.  
Dokumenti “Njoftim Detyrimi” i Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore Tiranë, konstatohet se është një format letër i printuar nga sistemi (pa datë, numër protokoll, firmë dhe vulë) që nuk përmban elementët e një shkrese zyrtare lëshuar nga një organ i administratës publike (në rastin konkret organ i pushtetit vendor), aq më tepër nuk është një dokument i lëshuar në formatin vërtetim siç është kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit.
  - Nuk ka plotësuar pika 1 gërma “ç” “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, ku kërkohet: *“[...]Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: d) Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”.*  
Në vërtetimin e paraqitur prej tij nuk është përfshirë fatura koherente e muajit Shtator 2016”.  
Vërtetimi i lëshuar nga OSHEE në muajin tetor 2016, nuk vërteton se operatori ekonomik ankimes në fjalë nuk ka detyrime të maturuara të energjisë elektrike deri në datën e zhvillimit të tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“INSTITUTI DEKLIADA-ALB”sh.p.k** me nr. NIPT-i K71606006A, me administrator Z.Devis Hasalami me adresë: Rruga “Dora Distr”, Tiranë, **me oferte ekonomike 5,400,000 (pesë milion katërqind mijë) lekë pa TVSH**, se është **identifikuar si oferta e suksesshme.**



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

[info@ukt.al](mailto:info@ukt.al)

NIPT J620050020

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 24.11.2016.

Ankesa: Ka ardhur ankesa Nr. 23849 prot datë 25.11.2016 nga operatori ekonomik “INSTITUTI DEKLIADA-ALB”sh.p.k, të cilës i është kthyer përgjigje me shkresën Nr.23849 Prot datë 30.11.2016, duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

Gjatë afatit kohor për ankesa në KPP: Ka ardhur ankesa nga operatori ekonomik “INSTITUTI DEKLIADA-ALB”sh.p.k.

Komisionin e Prokurimit Publik në vendimin K.P.P.Nr. 989/2016 datë 23.12.2016 ka vendosur:

*1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Instituti Dekliada-Alb” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-56164-11-01-2016 me objekt “Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e një hidrocentrali të ri në Lanabregas”, me fond limit 7.900.000 leke pa tvsh zhvilluar në datën 11.11.2016, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë.*

*2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “E.B.S.” shpk duke e skualifikuar atë nga procedura e prokurimit të sipërcituar.*

Më datë 06/01/2017 Autoriteti Kontraktor procedoi me rivlerësimin e ofertave duke skualifikuar operatorin ekonomik “E.B.S.”, në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 989/2016 datë 23.12.2016.

Me datë 19.02.2014 ka mbërritur vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 989/32017, i cili pranon kërkesën e autoritetit kontraktor për heqjen e pezullimit të te procedurës së prokurimit me objekt “Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e një hidrocentrali të ri në Lanabregas”.